



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Nr. 173 Prot.

Tiranë, më 09.1.2024

KËRKESË: Për t'u vetëmbledhur Komisioni Rregullator, për shqyrtimin e projektaktit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.22, datë 23.02.2022, të Komisionit Rregullator, "Për miratinin e Kodi të Etikës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve"

Drejtuar: **Z. Ilirjan Celibashi**
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Znj. Ilirjana Nano
Kryetare e Komisionit Rregullator

I nderuar z. Komisioner,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator,

Me Vendimin nr.22, datë 23.02.2022, Komisioni Rregullator ka miratuar Kodin e Etikës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në mbështetje të nenit 12, pika 4, nenit 20, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e një anëtari të Komisionit Rregullator, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij.

Neni 12, pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Rregullator, është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Neni 20, pika 1, shkronja "a" e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e projektaktit me karakter normativ, të përgatitur nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, mbi Kodin e Etikës së KQZ-së.

Në nenin 16 të Rregullores së Komisionit Rregullator është përcaktuar procedura për propozimin e projektakteve me karakter normativ, nga 1 anëtar i Komisionit Rregullator.

Për sa më sipër po ju paraqes këtë kërkesë, për vetëmbledhjen e Komisionit Rregullator, për shqyrtimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin Nr.22, dt.23.02.2022, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e Kodit të Etikës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", si dhe Projektaktin së bashku me relacionin përkatës.

Anëtar i Komisionit Rregullator
Dritan Caka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .1.2024 | Nr: | Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.22, DATË 23.02.2022, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE"

Në mbështetje të nenit 12, pika 4, nenit 20, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

- I. Në tekstin e Kodit të Etikës i miratuar me vendimin nr.22, datë 23.02.2022, të Komisionit Rregullator, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:
 1. Në nenin 7, pika 1, pas shkronjës "c", shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) Rregullat e hollësishme për veshjen dhe paraqitjen në punë, përcaktohen nga Rregullorja e Brendshme e institucionit."
 2. Në nenin 9, paragrafi i dytë, përpara fjalës "punonjësit" shtohet "zyrtarët/".
 3. Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

Data: .1.2024 Nr:
Ora:



Për disa shtesa dhe ndryshime në
vendimin nr.22, datë 23.03.2023, të
Komisionit Rregullator

a) Në pikën 3 fjala “Nëpunësi” zëvendësohet me “Zyrtari/punonjësi”.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“ 6. Zyrtari/punonjësi, i cili gjatë ushtrimit të detyrave të tij, ka fituar ose ka njohuri mbi të dhëna personale të individëve/subjekteve, i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit mbi to, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9887, dt.10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.”.

4. Në nenin 15, pika 2, pas fjalës “ish-zyrtari” shtohet “/ish-punonjësi”.

5. Pas nenit 15, shtohen nenet 15/1 dhe 15/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1

Komunikimi me median

Në lidhje me marrëdhënien me median dhe deklaratimet publike, zyrtari/punonjësi nuk duhet të bëjë deklarime në publik ose media, që mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit, si dhe që mund të interpretohen apo lidhen me pozicionin e tij në KQZ.

Neni 15/2

Kontaktet me organe të tjera të administratës publike/shtetërore

Zyrtari/punonjësi, duhet të respektojë rregullat e etikës të përcaktuara në këtë Kod, në çdo rast kur kontakton me organe të tjera të administratës publike/shtetërore dhe punonjës të saj. Në këto kontakte ai duhet, paraprakisht, të bëjë prezantimin zyrtar nëpërmjet kartës identifikuese të institucionit, të shpjegojë qëllimin e kontaktit, si dhe të shmangë çdo shfaqje të arrogancës apo presionit ndaj një organi tjetër të administratës publike/shtetërore.”.

6. Në nenin 16, pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“3. Zyrtari/punonjësi duhet të kërkojë këshillim nga njësia e personelit te institucionit kur është i pasigurt për të vepruar.

4. Eprori direkt i zyrtarit/punonjësit ka përgjegjësi të kontrollojë nëse ai zbaton rregullat e treguara ne këtë Kod dhe të propozojë masat e duhura disiplinore për shkeljet e tij.


5. Shkeljet e rregullave të përcaktuara në këtë Kod, kur nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen në rrugë administrative, sipas legjislacionit në fuqi.”.

7. Kudo në tekst pas fjalëve “zyrtari”, “zyrtarët” shtohet “/punonjësi”, “/punonjësit”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar

Data: .1.2024 Nr:
Ora:



Për disa shtesa dhe ndryshime në
vendimin nr.22, datë 23.03.2023, të
Komisionit Rregullator